

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës
Nr. 02-55617-07
Prishtinë, më 12 korrik 2007
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 73 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 28 e 29 qershorit 2007,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizmat e modifikuara gjenetikisht,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët nr. 2003/11,
7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës dhe
8. Shqyrtimi i Propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës.

Në fillim të seancës, **kryetari** i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës së Kuvendit e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Në ndërkohë, asnjë grup parlamentar nuk ka parashtruar ndonjë amendament në rendin e ditës.

Ramadan Kelmendi ripërsëriti kërkesën e Grupit Parlamentar të LDD-së që Kuvendi të debatojë lidhur me ndërtimet ilegale të banesave nga Qeveria e Serbisë në pjesën veriore të Mitrovicës.

Përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare e mbështetën kërkesën e Grupit Parlamentar të LDD-së që në seancën e radhës të debatohet lidhur me ndërtimet ilegale të banesave nga Qeveria e Serbisë në pjesën Veriore të Mitrovicës, por paraprakisht Qeveria e Kosovës dhe komuna e Mitrovicës duhet të përgatisin një informatë si material bazë për diskutim.

Jakup Krasniqi, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi të caktohet data e mbajtjes së seancës së veçantë për të debatuar për procesin politik lidhur me vazhdimin e zgjidhjes së statusit të Kosovës.

Pas diskutimeve të deputetëve dhe të konsultimeve të kryetarëve të grupeve parlamentare me Kryesinë e Kuvendit, **kryetari** deklaroi se Kryesia e Kuvendit do të takohet me Ekipin e Unitetit për ta caktuar datën e mbajtjes të seancës së veçantë për të debatuar lidhur me vazhdimin e zgjidhjes së statusit të Kosovës.

Deputeti **Nazim Jashari**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës pika e tetë: Shqyrtimi i Propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të ORA-s. Kuvendi, me shumicë votash, nuk e miratoi kërkesën e këtij grupi.

Kryetari dha pauzë për drekë.

Pas drekës seancën e kryesoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 28 e 29 qershorit 2007

Procesverbali i seancës plenare të 28 e 29 qershorit 2007 u miratua pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Sala Berisha-Shala** i parashtrroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme lidhur me veprimet e kësaj ministrie për dhënien e dokumenteve në komunën e Drenasit.

Ministri **Blerim Kuçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Shala.

Deputeti **Nait Hasani** i parashtrroi pyetje zëvendësministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe të Zhvillimit Rural lidhur me veprimet e kësaj ministrie për t'i ndihmuar banorët e fshatit Vrellë, komuna e Istogut, për t'u mbrojtur nga vërshimet.

Zëvendësministri **Tomë Hajdaraj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Hasani.

Pyetjet e deputetëve: **Xhevat Bislimi, Safete Hadrërgjonaj dhe Fetah Berisha** që ia kishin parashtruar kryeministrit të Kosovës, z. **Agim Çeku**, dhe deputetja **Hatixhe Hoxha** pyetje për ministrat **Bujar Dugolli** dhe **Agim Veliu** u shtyn për seancën tjetër të radhës, ngase ata nuk ishin të pranishëm në seancë.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryesuesi e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministrja e Shërbimeve Publike, **Melihate Tërmkoll**i, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim ministrja **Tërmkoll**i e arsyetoi qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, pjesën përfundimtare, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij Projektligji nga ministrja **Tërmkoll**i, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë në emër të grupeve parlamentare: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Nekibe Kelmendi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK- **Hydajet Hyseni**, emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ymer Halimi**, emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Genc Gorani**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi**, në emër të Grupit Parlamentar 6 Plus, **Shpresa Murati** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Vezira Emrush**, si deputetët: **Naser Osmani, Fetah Berisha dhe Gani Koci**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 66;

Kundër----- 4.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi në parim Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media - Komision Përgjegjës Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore

Kryesuesi e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor, **z. Ardian Gjini**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim ministri **Gjini** e arsyetoi qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore, pjesën përfundimtare, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Gjini**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë në emër të grupeve parlamentare: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Shaban Halimi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK- **Nerxhivane Dauti**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Mazlomm Kumnova**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Gazmend Muhaxheri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Milazim Haliti**, në emër të Grupit Parlamentar 6 Plus, **Rifat Krasniq** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, **Vezira Emrush**, si deputetët: **Naxhije Doçi**, **Nekibe Kelmendi**, **Ramadan Kelmendi** dhe **Gani Koci**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas kësaj kohe seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 69;

Kundër----- 2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi në parim Projektligjin për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Komision Përgjegjës Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikiisht

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe i Zhvillimit Rural, **z. Tomë Hajdaraj**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim zëvendësministri **Hajdaraj** e arsyetoi qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikiisht, pjesën përfundimtare, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri **Hajdaraj**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë në emër të grupeve parlamentare: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Jusuf Sutaj**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK- **Selviqe Halimi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Xhevdet Neziraj**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Fatmire Mulhaxha-Kollçaku** dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, që i janë bashkangjitur transkriptitit.

Në fund, zëvendësministri **Hajdaraj** iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 60;

Kundër----- 6.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi në parim Projektligjin për organizmat e modifikuar gjenetikisht .

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Komision Përgjegjës Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/11 për rrugët

Në mungesë të ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit për ta arsyetuar, para deputetëve të Kuvendit, shqyrtimi i këtij projektligji u shty për seancën tjetër të radhës.

7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Arsim, Shkencë Teknologji, Kulturë, Rini e Sport ta arsyetonte rekomandimin e komisionit para deputetëve të Kuvendit.

Kryetari i Komisionit, **Nimon Alimusaj**, e paraqiti qëndrimin e Komisionit Funkcional lidhur me propozimvendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës.

Kryetari e hodhi në votim propozimvendimin e Qeverisë së Kosovës. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----40;

Kundër----- 15.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës

I. Anëtarë të Këshillit Kombëtar të Shkencës emërohen:

1. Akademik Rexhep Ismajli, Akademia e Shkencë dhe e Arteve e Kosovës,
2. Dr. Zejnullah Rrahmani, Fakulteti i Filologjisë -Universiteti i Prishtinës,
3. Dr. Jahja Drançolli, Fakulteti Filozofik - Universiteti i Prishtinës,
4. Dr. Dugagjin Pupovci, Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore UP, Prishtinë,
5. Dr. Fetah Podvorica, Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore UP, Prishtinë,
6. Dr. Skender Kaçiu, Fakulteti i Bujqësisë, UP, Prishtinë,
7. Dr. Zejnullah Gruda, Fakulteti i Drejtësisë, UP, Prishtinë,
8. Dr. Nexhmi Rexha, Fakulteti Ekonomik, UP, Prishtinë,
9. Dr. Isuf Krasniqi, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, UP, Prishtinë,
10. Dr. Xhevat Perjuci, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, UP, Prishtinë,
11. Dr. Abdyl Krasniqi, Fakulteti i Mjekësisë, UP, Prishtinë,
12. Dr. Suzana Manxhuka, Rektorati i Universitetit të Prishtinës,
13. Akademik Rexhep Ferri, Fakulteti i Arteve të Bukura, UP, Prishtinë,
14. Dr. Radivoje Mançiq, Instituti i Ekologjisë "Ekoman", Shtërpcë dhe
15. Mr. Husnija Bibuljica, Fakulteti i Biznesit, Pejë.

II.Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës zgjat katër (4) vjet.

8. Shqyrtimi i Propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës

Kryetari e arsyetoi para deputetëve Propozimin e Kryesisë së Kuvendit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës.

Ai, pas arsyetimit të propozimit, e hapi diskutimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Kuvendit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Kuvendit dhanë në emër të grupeve parlamentare: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Sabri Hamiti**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Hydajet Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Sylja**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Gazmend Muhaxheri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi** dhe në emër të Grupit Parlamentar 6 Plus, **Mahit Yagcilar**, si dhe deputetët: **Sadudin Berisha**, **Xhevat Bislimi**, **Behxhet Brajshori**, **Nazim Jashari**, **Alush Gashi** dhe **Xhavit Haliti**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Kuvendit. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----55;

Kundër-----18.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Miratohet në parim propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Kuvendit.
2. Kërkohet nga deputetët dhe grupet parlamentare që propozimet për ndryshimin dhe plotësimin Rregullores së punës të Kuvendit t'ia paraqesin Kryesisë së Kuvendit në një afat optimal.
3. Kryesia e Kuvendit, pas shqyrtimit dhe harmonizimit të amendamenteve, tekstin përfundimtar të propozimit për ndryshimin dhe plotësimin Rregullores së punës duhet t'ia paraqes Kuvendin për miratim në seancën e radhës.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 17: 30 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë Berisha

E hartoi

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale